



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 3 Regj.Them.

Datë 12.07.2024 Rregjistrimi

Nr. 3 Vendimi

Datë Vendimi 17.07.2024

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare:	Manjola Xhaxho	<i>(Relatore)</i>
Gjyqtare:	Edlira Petri	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtare:	Nafije Hasko	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtare:	Marsela Dervishi	<i>(Anëtare)</i>
Gjyqtar:	Sokol Ibi	<i>(Anëtar)</i>

asistuar nga sekretare gjyqësore Besa Llabunishti, më datë 17.07.2024, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen nr. 3 regj. them., datë 12.07.2024, që i përket palëve:

PADITËS: Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Eridian Salianji.

I PADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (Komisioni Rregullator) përfaqësuar në gjykim nga Znj. Juneta Dumi dhe Z.Erdal Mema.

PERSON I INTERESUAR: Koalicioni Bashkë Fitojmë, i cili nuk u paraqit, duke e lënë gjykimin në mungesë

OBJEKTI:

- Kundërshtim ndaj mosmarrjes vendim nga Komisioni Rregullator në KQZ, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.
- Detyrimin e Komisionit Rregullator në KQZ për të marrë menjëherë vendim “Për miratimin e disa afateve procedurale që

lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

BAZA LIGJORE

Nenet 26,145, 152, 153, 155, 156, 158, pika 1, shkronja “c” dhe pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”; (i ndryshuar).

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pasi dëgjoi palën paditëse që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit ose miratimin nga Kolegji Zgjedhor të projektvendimit; palën e paditur që e la në vlerësim të Kolegjit Zgjedhor zgjidhjen e çështjes; si dhe mori në shqyrtim provat dhe analizoi ligjit,

VËREN

1. Kolegji vë në dukje se Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 92, shkronja “gj” dhe nenit 93, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 244, datë 05.07.2024 “Përcaktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë”, ka caktuar datën 4 Gusht 2024, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë.

2. Me njoftimin e datës 06.07.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është propozuar thirrja e Komisionit Rregullator për të miratuar disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë. Mbledhja e Komisionit Rregullator është zhvilluar datë 9.7.2024, ora 16.30 me rend dite: *Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024"*. Ky projektvendim është përgatitur nga administrata e KQZ dhe i është propozuar Komisionit Rregullator nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

3. Gjatë shqyrtimit dhe diskutimit të projektvendimit, nga ana e dy anëtarëve të Komisionit Rregullator është votuar kundër dhe në kushtet e ndarjes së votave 3 pro me 2 kunder, në bazë të nenit 20 ,pika 3 e Kodit Zgjedhor nuk është konkluduar me vendimmarrje.

4. Subjekti zgjedhor, pala paditëse, që ka qenë prezent në mbledhje, duke mos qene dakord me këtë situatë, ka paraqitur më datë 12.07.2024 padinë objekt gjykimi. Pala paditëse pretendoi në padi dhe gjatë gjykimit që Komisioni Rregullator në bazë të nenit 20, pika 3 e Kodit Zgjedhor nuk ka marrë vendim duke cenuar dhe vënë në rrezik zhvillimin e procesin zgjedhor. Sipas palës paditëse neni 145, pika 2 parashikon se *Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor nuk e gjykon çështjen në themel dhe, kur pranon kërkesën, vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim dhe neni 158 ,pika 1, gërma “e” i Kodit Zgjedhor përcakton se në varësi nga çështjet në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë*

vendim. Pala paditëse në bazë të këtij rregullimi ligjor me padinë objekt gjykimi kërkon që Kolegji Zgjedhor të detyrojë Komisionin Rregullator të marrë vendim. Pala paditëse argumentoi se shkak për të cilin dy anëtarët e Komisionit Rregullator votuan kundër miratimit të projektvendimit ishte se vendimi nr. 69, datë 5.7.2024, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dates 14 maj 2023" dhe Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 244, datë 5.7.2024, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë", janë marrë në kundërshtim me ligjin dhe për pasojë nuk mund të merrin një vendim për miratimin e afateve procedurale, për shkak se buron nga akte, të cilat janë absolutisht të pavlefshme. Sipas palës paditëse në këto kushte këta anëtarë të Komisionit Rregullator kanë votuar kundër në parim dhe për këtë shkak nuk është miratuar projektvendimi. Sipas palës paditëse në përputhje me nenin 20, pika 3 të Kodit Zgjedhor ky projektvendim nuk mori shumicën e kërkuar nga Kodi Zgjedhor për t'u konsideruar i miratuar. Pala paditëse parashtroi se anëtarët e Komisionit Rregullator nuk kanë marrë vendim sipas kompetencave që i njeh Kodi Zgjedhor, kompetence që e kanë ushtruar në raste të ngjashme më parë, kur me vendim nr. 2, datë 22 janar 2022 kanë miratuar disa afate procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që janë zhvilluar më 6 mars 2022, shtuar me vendimin nr. 8, datë 27.1.2022 apo me vendimin nr. 28, datë 16.8.2023 për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Kukës, që janë zhvilluar më datë 24 shtator 2023. Sipas palës paditëse nuk është kompetencë e Komisionit Rregullator të marrë në shqyrtim vlefshmërinë e akteve administrative, vendim nr. 69, datë 5.7.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Dekret i Presidentit nr. 244, datë 5.7.2024, por janë përkatësisht Gjykata dhe KAS. Përfundimisht sipas palës paditëse Komisioni Rregullator ka detyrimin të shqyrtojë projektvendimin sipas kompetencës ligjore të parashikuar në nenin 20 të Kodit Zgjedhor. Gjate gjykimit pala paditëse mbajti qëndrim alternativ duke kërkuar që Kolegji Zgjedhor të miratojë projektvendimin nisur nga afatet e ngutshme procedurale që paraqet ceshtja.

5. Pala e paditur parashtroi se Komisioni Rregullator ka marrë në shqyrtim projektvendimin "*Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024*" dhe votat në shqyrtimin në parim janë ndarë 3 vota pro dhe 2 vota kundër dhe për pasojë në bazë të nenit 20, pika 3 e Kodit Zgjedhor vendimi i mësipërm nuk mund të konsiderohet i miratuar. Pala e paditur e la në vlerësim të Kolegjit zgjidhjen e çështjes.

ARSYETIMI I KOLEGJIT

6. Kolegji Zgjedhor thekson se në kuptim të nenit 20, pika 1, gërma "a" të Kodit Zgjedhor rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për: a) rregullat e detajuara për organizimin dhe

administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, detyrat e administratës zgjedhore dhe procedurat që zbatohen në zgjedhje. I tillë është dhe projektvendimi objekt gjykimi "Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024" që është shtruar për miratim në mbledhjen e datës 09.07.2024 të Komisionit Rregullator.

7. Neni 20, pika 3 e Kodit Zgjedhor përcakton se *Aktet administrative bazë të Rregullatorit në ushtrimin e detyrës janë vendimet. Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku katër anëtarë, përveç vendimeve sipas shkronjave "b" dhe "d" të pikës 2 të këtij neni, të cilat miratohen me shumicë të thjeshtë.* Në kuptim të këtij neni, projekt vendimi i mësipërm nuk është miratuar pasi dy nga anëtarët e Rregullatorit kanë votuar kundër, ndërsa tre pro. Kolegji thekson se Komisioni Rregullator ka zhvilluar mbledhjen në bazë të kompetencës së parashikuar nga Kodi Zgjedhor dhe pasi ka shqyrtuar projektvendimin, për shkaqet që secili prej antarëve ka vlerësuar, nuk ka miratuar projektvendimin, pasi votat janë ndarë 2 (kundër) me 3(pro) dhe duhen 4 për të miratuar me vendim aktin normativ të propozuar.

8. Sa me siper, Kolegji vlerëson se nuk jemi në kushtet që të detyroje Komisionin Rregullator, që të rivotojë projektvendimin, pasi tashmë ai e ka marrë në shqyrtim dhe anëtarët e tij kanë bërë vlerësimin e tyre për aktin dhe kanë votuar pa arritur kuorrumin nevojshme për vendimmarrjen. Kolegji ve ne dukje se pala paditëse, dhe sipas sqarimit gjatë gjykimit, objekt mosmarrëveshje ka miratimin e projektvendimit, që parashikon afate procedurale për zhvillimin e zgjedhjeve vendore ne Bashkinë Himarë. Kolegji Zgjedhor në bazë të nenit 158, pika 1 gërma "b" të Kodit Zgjedhor që parashikon se *në varësi të çështjes në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos gjykimin e çështjes në themel,* vlerëson se është para situatës procedurale që, si organi i vetëm procedural, duhet të zgjidhë mosmarrëveshjen objekt gjykimi, të paraqitur nga pala paditëse, e cila ka interes si subjekt zgjedhor në kuptim të nenit 145 pika 1 të Kodit Zgjedhor që përcakton se *Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi.*

9. Në gjykim u administrua projektvendim dhe relacioni perkates nr. 2029, date 17.07.2024 për miratimin e disa afateve procedurale te perditesuara që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024 te përgatitura nga KQZ. Sipas KQZ -se keto afate garantojne realizimin e procesit zgjedhor ne perputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

10. Kolegji Zgjedhor, afatet e propozuara i gjen të bazuara në Kodin Zgjedhor dhe në reflektim të situatës kohore në momentin e hartimit të tyre, në raport me datën e zgjedhjeve. Këto afate procedurale janë të reduktuara dhe respektojnë kronologjinë e veprimeve të cilat parashikohen në Kodin Zgjedhor, te nevojshme për të garantuar zgjedhjet, nder te tjera edhe kohëzgjatja e fushates zgjedhore, detyrimi per raportim i të gjithë institucioneve për veprimtarinë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë, monitorimi i OSHMA-ve nga Autoriteti i Mediave

Audiovizive, regjistrimi i subjekteve zgjedhore, përcaktimi i afatit për subjektet zgjedhore për paraqitjen e propozimeve për anëtarë të Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe Grupet e Numërimit të Votave, afati për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore si dhe organizatave joqeveritare shqiptare EVE dhe të huaja, si dhe publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158/1/b, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash:

VENDOSI:

Miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024 si më poshtë:

1. Bashkia Himarë dhe institucionet e saj të varësisë, janë të detyruara të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 26.7.2024 deri më datë 4.8.2024.
Të njëjtin detyrim kanë edhe institucionet publike qendrore, organet e tyre të varësisë dhe degët e tyre vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, për veprimtari me karakter publik, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 26.7.2024 deri më datë 4.8.2024, në territorin e Bashkisë Himarë, ose për të.
2. Autoriteti i Mediave Audiovizive monitoron OSHMA-të për veprimtaritë me karakter publik të institucioneve publike të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, nga data 26.7.2024, nga ora 08:00-00:00, ose sipas rastit, deri në përfundimin e programit.
3. Kryetari i Bashkisë në detyrë paraqet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, listën e plotë të objekteve të qendrave të votimit që përmbushin kushtet e parashikuara në ligj, jo më vonë se data 19.7.2024.
4. Kryetari i Bashkisë në detyrë të përcaktojë vendet publike, në territorin e Bashkisë Himarë, për afishimin nga subjektet zgjedhore të materialeve propagandistike, jo më vonë se data 25.7.2024.
5. Partitë politike, të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë në KQV, duhet t'i depozitojnë ato në KZAZ-në nr. 88, jo më vonë se data 19.7.2024. KZAZ-ja merr vendim për emërimin e anëtarëve të KQV-ve, jo më vonë se data 20.7.2024.
6. Partitë politike, të cilat kanë të drejtë të paraqesin anëtarë në GNV, duhet t'i depozitojnë ato në KZAZ, jo më vonë se data 24.7.2024. KZAZ-ja merr vendim për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, jo më vonë se 25.7.2024.
7. Partitë politike duhet të paraqesin kërkesën në KQZ, për regjistrim si subjekte zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, jo më vonë se ora 16.00 e

datës 22.7.2024. KQZ-ja kthen për plotësim dokumentacionin brenda 8 (tetë) orëve nga dorëzimi. Partitë politike paraqesin dokumentacionin e korrigjuar brenda orës 12.00 të datës 23.7.2024. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos për kërkesat për regjistrim brenda 3 (tre) orëve nga ridërgimi i dokumentacionit të korrigjuar.

8. Komitetet Nismëtare duhet të paraqesin kërkesën për regjistrim për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar në Bashkinë Himarë, në KZAZ, jo më vonë se ora 16.00 e datës 22.7.2024. KZAZ-ja kthen për plotësim dokumentacionin brenda 8 (tetë) orëve nga dorëzimi. Komitetet Nismëtare paraqesin dokumentacionin e korrigjuar brenda orës 12.00 të datës 23.7.2024. KZAZ-ja vendos për kërkesat për regjistrim brenda 3 (tre) orëve nga ridërgimi i dokumentacionit të korrigjuar.
9. Koalicionet zgjedhore duhet të paraqesin në KQZ kërkesën për regjistrimin si koalicion për zgjedhjet e pjeshme për kryetar në Bashkinë Himarë jo më vonë se ora 12:00 e datës 24.7.2024. KQZ-ja kthen për plotësim dokumentacionin brenda 2 (dy) orëve nga dorëzimi. Partitë politike paraqesin dokumentacionin e korrigjuar brenda orës 18.00 të datës 24.7.2024. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendos për kërkesat për regjistrim brenda 3 (tre) orëve nga ridërgimi i dokumentacionit.
10. Dokumentet e kandidimit paraqiten në KZAZ jo më vonë se ora 16.00 e datës 25.7.2024. KZAZ-ja bën verifikimin e tyre, jo më vonë se 4 (katër) orë nga paraqitja, dhe në rast se vëren parregullsi, i kthen për plotësim. Dokumentet e plotësuara duhet të riparaqiten jo më vonë se ora 12.00 e datës 26.7.2024. KZAZ-ja merr vendim jo më vonë se 4 (katër) orë nga riparaqitja e tyre.
11. Fushata zgjedhore për zgjedhjet e pjeshme për Kryetar në Bashkinë Himarë, fillon më datë 27.7.2024.
12. Paraqitja e kërkesës për akreditimin e vëzhguesve shqiptarë dhe për vëzhguesit e huaj bëhet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se data 1.8.2024.
13. Paraqitja e kërkesës për akreditim nga ana e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje bëhet në KZAZ jo më vonë se data 1.8.2024.
14. Ngarkohen administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe institucionet e tjera të përmendura në këtë vendim, për zbatimin e tij.
15. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim

U shpall në Tiranë, më datë 17.07.2024

ANËTARE	ANËTAR	ANËTARE	ANËTARE	RELATORE
Marsela Dervishi	Sokol Ibi	Edlira Petri	Nafije Hasko	Manjola Xhaxho
Kundër				
dv	dv	dv	dv	dv

Vvrtetohet njwsia me origjinalin